

NJOFTIM PUBLIK

PËR PARAQITJEN E APLIKIMEVE PËR TË PËRFITUAR MBËSHTETJE FINANCIARE, NGA STUDENTËT E REGJISTRUAR NË VITIN AKADEMIK 2023-2024.

Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë, në mbështetje të Vendimit nr.386 datë 1.6.2022 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer e të studentëve, që ndjekin këto programe në institucionet publike të arsimit të lartë”, i ndryshuar, bën publik njoftimin si më poshtë:

Studentët, shtetas shqiptarë, të pranuar në institucionet publike të arsimit të lartë, për vitin akademik 2023- 2024, për program të parë studimi **mund të aplikojnë për të përfituar mbështetje financiare** nga buxheti i shtetit, sipas kriterëve të përcaktuara, sipas Vendimit Nr. 386, datë 1.6.2022, ndryshuar me VKM-në nr.397, datë 29.6.2023, sipas kategorive më poshtë:

- **Studentë të shkëlqyer:**

Studenti me notë mesatare në pranim, që:

i. kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë me notë mesatare 10.00;

ii. në secilin prej provimeve kombëtare të detyruara të maturës shtetërore është vlerësuar me jo më pak se nota e shkallëzuar 9.5 deri në 10.00.

- **Studentët fitues të olimpiadave:**

Studenti fitues i njërit prej tri çmimeve të para, në olimpiadat ndërkombëtare të arsimit parauniversitar, me më shumë se 15 vende pjesëmarrëse, pavarësisht notës mesatare, kur pranohet në programe studimi, që lidhen me lëndën/t/disiplinën ku ka fituar çmimin.

- **Studentë në programe prioritare:**

Studenti i cili ka zgjedhur të ndjekë një prej programeve të studimit, që përbën prioritet kombëtar, të përcaktuar me Vendim nr.386 datë 1.6.2022 të Këshillit të Ministrave të ndryshuar me VKM nr.397, datë 29.6.2023.

Aplikimet dorëzohen pranë Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL), në rrugë postare, me e-mail ne adresën: info.akfal@arsimi.gov.al ose dorazi në adresën: rruga “Naim Frashëri”, nr.37, Tiranë, nga data 18 Tetor 2023 – 18 Dhjetor 2023.

Formulari i aplikimit, sipas modelit bashkëngjitur, vihet në dispozicion pranë AKFAL-it:

**Përzgjedhja e studentëve përfitues të programeve të studimit që përbëjnë prioritet kombëtar dhe studentëve të shkëlqyer, që ndjekin këto programe në institucionet publike të arsimit të lartë, kryhet sipas pikës 6 dhe 6/1 të Vendimit Nr. 386, datë 1.6.2022, e ndryshuar me VKM- së nr. 397, datë 29.6.2023.*

FORMULAR APLIKIMI

PËR PËRFITIM TË MBËSHTETJES FINANCIARE

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME TË STUDENTIT APLIKUES		
Emër, Atësi, Mbiemër: _____	Datëlindja: _____	
Numri identifikimit personal të studentit (sipas Kartës identi. / Pasaportës): _____		
Të dhëna personale:	Email: _____	
	Nr. Tel: _____	
Institucioni publik i arsimit të lartë, ku është regjistruar studenti aplikues:	_____	
Programi i studimit, ku studenti është regjistruar:		
Zgjidh llojin e programit (shëno kutinë përkatëse): - Program i ciklit të parë të studimit <input type="checkbox"/> - Program i integruar i studimeve të ciklit të dytë <input type="checkbox"/>	Emërtimi i programit të studimit: _____	
Viti akademik i regjistrimit të studentit aplikues	2023-2024	
KËRKESË PËR PËRFITIM TË MBËSHTETJES FINANCIARE		
Unë, kërkuesi, paraqes kërkesën time për përfitim të mbështetjes financiare, në mbështetje të VKM Nr.386, datë 1.6.2022 “Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer e të studentëve, që ndjekin këto programe në institucionet publike të arsimit të lartë”, të ndryshuar me VKM Nr. 397, datë 29.06.2023, sepse plotësoj kriterin si më poshtë: <i>Zgjidh njërin nga kriteret e mëposhtëme dhe shëno kutinë përkatëse.</i>		
<input type="checkbox"/> KRITERI - A	Student i pranuar, me notë mesatare “të shkëlqyer” , që: i) ka përfunduar arsimin e mesëm të lartë me notë mesatare 10.00; dhe ii) në secilin prej provimeve kombëtare të detyruara të maturës shtetërore është vlerësuar me jo më pak se nota e shkallëzuar 9.5 deri në 10.00;	
<input type="checkbox"/> KRITERI - B	Student i pranuar, që është fitues i njërit prej tri çmimeve të para në olimpiadat ndërkombëtare të arsimit parauniversitar, me më shumë se 15 vende pjesëmarrëse, pavarësisht notës mesatare, kur pranohet në programe studimi, që lidhen me lëndën/t/disiplinën ku ka fituar çmimin;	
<input type="checkbox"/> KRITERI - C	Student i pranuar, i cili ka zgjedhur të ndjekë një prej programeve të studimit, që përbën prioritet kombëtar;	
<p>Deklaroj vërtetësinë e të dhënave të paraqitura. Jam i/e vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p> <p>Pranoj të lidh marrëveshje me AKFAL për përfitimin e mbështetjes financiare, sipas përcaktimeve të Vendimit Nr. 386, datë 1.6.2022, e ndryshuar me VKM- së nr. 397, datë 29.6.2023.</p> <p>Autorizoj MAS dhe/ose AKFAL për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit tim.</p> <p style="text-align: center;">KËRKUESI</p> <p style="text-align: center;">_____</p> <p style="text-align: center;"><i>emri, mbiemri, nënshkrimi</i></p>		